



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA PLENARE KONSTITUIVE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 21.02. 2011**

**SA KONSTITUTIVNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 21.02. 2011. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2011**

E hënë, më 21.02.2011,

Drejtton seancën: Flora Brovina, deputetja më e moshuar në këtë legjislaturë të Kuvendit, e asistuar nga deputetja më e re nga mosha, Biserka Kostiq.

KRYESUESJA: Të nderuar të pranishëm,
Kam nderin dhe kënaqësinë që në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, unë Flora Brovina, në cilësinë e deputetit të këtij Kuvendi ta kryesoj mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, më 12 dhjetor 2010.

Për drejtimin e mbledhjes do të më ndihmojë edhe deputetja më e re nga mosha, zonja Biserka Kostiq.

Në këtë rast, më lejoni që në fillim t'ju dëshiroj mirëseardhje, punë të mbarë të gjithë deputetëve të legjislaturës të katërt. Njëkohësisht, kam kënaqësinë e veçantë që t'i përshëndes dhe t'ju dëshiroj mirëseardhje edhe mysafirëve të nderuar që marrin pjesë në këtë mbledhje konstituive, së pari, ushtruesin e detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës, zotin Jakup Krasniqi, përfaqësuesin e Zyrës Ndërkombëtare Civile, zotin Pieter Feith, komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Buehler, raportuesen e Parlamentit të Evropës, zonjën Ulrike Lunacek, ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotin Kristofer Dell, ambasadorët dhe përfaqësuesit e zyrave diplomatike në Kosovë, përfaqësuesit e bashkësive fetare të Kosovës dhe të gjithë të ftuarit të pranishëm në këtë mbledhje konstituive dhe përfaqësuesit e medieve që ndodhen këtu.

Prezenca e deputetëve është 117 deputetë, 3 mungojnë.

Vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Tani propozoj të procedojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve

Ju njoftoj se në bazë të nenit 9.4 të Rregullores së Kuvendit, subjektet politike përfaqësuese në Kuvend duhet të propozojnë nga një deputet në Komisionin e përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve. Ky Komision duhet të shqyrtojë dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të mbajtura më 12 dhjetor 2010, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor, dokumentacionin e regjistrimit të deputetëve dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, si dhe të verifikojë kuorumin në mbledhjen konstituive të legjislacionit të Kuvendit. Andaj, ftoj përfaqësuesit e subjekteve politike që t'ju propozojnë emrat e deputetëve për anëtarë të këtij komisioni. Ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike të Kosovës që ta propozojë një kandidat. E ka fjalën Fatmir Limaj. Urdhëro, dil në foltore, sepse s'kemi kartela.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Në emër të deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, propozojmë Idriz Vehapin.

KRYESUESJA: Në emër të deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Përshëndetje, kryesuese!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandateve dhe të kuorumit, propozon deputetin Armend Zemaj.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes” Vetëvendosje”, propozoj Alma Lamën.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Ftoj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

E ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon zonjën Teuta Haxhiun.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Nga Koalicioni AKR, PSD, PD etj.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Nga Koalicioni AKR, PD, PSD, propozojmë deputeten Myzejene Selmani. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ju faleminderit!

Nga komuniteti serb ftoj që të propozoni një anëtar.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedavajući!

U ime Samostalne Liberalne Strane u Komisiji će biti poslanica Jelena Bontić.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Ftoj nga komunitetet tjera që të propozoni një anëtar për këtë komision.

MAHIR YAGCILAR: Teşekkür ederim sayın divan başkanı,

6+ Grup adına da Albert Kinoli milletvekili komisyonuna öneriyoruz.

KRYESUESJA: Faleminderit shumë!

Atëherë i lus deputetët që me ngritje dore të deklarohe mi kush është “për” këtë komision, kush është “kundër” dhe nëse ka abstenime.

Pyes, kush është “për” këtë komision? A ka “kundër”, a ka abstenime? Ju faleminderit! Konstatoj se njëzëri pajtohe mi që të formohet ky komision në këtë përbërje.

Konstatohet se Komisioni emëroi anëtarët e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve. Ftoj Komisionin që të takohet menjëherë në sallën numër 303 dhe pastaj Kuvendit t'i paraqesë raportin. Pauza 10 minuta. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESJA: I lus deputetët t'i zënë vendet e tyre dhe të vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Ftoj kryesuesin e Komisionit të përkohshëm për verifikime dhe kuorum dhe mandate, zotin Idriz Vehapi, që të paraqesë raportin e komisionit.

IDRIZ VEHAPI: E nderuara zonja kryesuese,

Të nderuar të pranishëm,

Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve paraqet këtë raport. Për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe mandatit, i themeluar në mbledhjen e sotme konstituive të legjislaturës së katërt, më 21 shkurt 2011, në pajtim me nenin 9, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2011, shqyrtoi dokumentacionin zgjedhor, si në vijim.

Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të datës 7 shkurt 2011, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura më 12 dhjetor 2010, Listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor konstatoi:

Në legjislaturën e katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga subjektet politike, koalicionet, iniciativat qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e datës 12 dhjetor 2010, si vijon: Partia Demokratike e Kosovës - 34 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës - 27 deputetë, Vetëvendosja - 14 deputetë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - 12 deputetë, Koalicioni AKR, PD, PSD, PPI, PPK, PNDSH dhe PGJK- 8 deputetë, subjekti SLS - 8 deputetë, subjekti KDTP - 3 deputetë, subjekti JSL - 4 deputetë, subjekti Vakaf - 2 deputetë, subjekti PDAK - 1 deputet, subjekti NDS - 1 deputet, subjekti PSDAK - 1 deputet, subjekti RDK - 1 deputet, subjekti PAI - 1 deputet, subjekti SDSKIM - 1 deputet, subjekti GIK - 1 deputet dhe subjekti PREBK - 1 deputet.

Komisioni njëherësh konstatoi se në bazë të evidencës së deputetëve prezentë në mbledhjen e sotme konstituive të legjislaturës së katërt, janë të pranishëm 118 deputetë. Në bazë të këtyre konstatimeve, Komisioni i rekomandon Kuvendit që të bëjë verifikimin e mandateve të deputetëve dhe t'i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës.

Prishtinë, më 21 shkurt 2011.

Kryesuesi i komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe mandateve, unë, Idriz Vehapi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit!

Konstatoj se të pranishëm janë 118 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për raportin e Komisionit. Kush deklarohet “për”, “kundër” dhe abstenim. Votojmë. Kush është “për”? Ju faleminderit, shumica. A ka “kundër”? Jo. A ka abstenime? Jo. Konstatoj se njëzëri pranohet Raporti i komisionit të përkohshëm.

Konstatoj se Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit për verifikime, kuorum dhe mandate.

Të nderuar deputetë,
Tani procedojmë me pikën dy të rendit të ditës.

2. Dhënia e betimit të deputetëve

KRYESUESJA: Ju njoftoj se betimi solemn i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutën e Kosovës dhe Rregulloren e Kuvendit. Tekstin e deklaratës së betimit secili deputet e ka para vetes dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht. Për të përmbushur këtë detyrë, lus deputetët që të ngrihen në këmbë dhe të dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund të gjithë së bashku të shqiptojnë fjalën – betohem, secili në gjuhën e vet.

(Deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” gjatë betimit nxorën përpara flamurin kombëtar)

“Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, betohem se me nder, me përkushtim do të kryej detyrën time dhe do të përfaqësoj me dinjitet popullin tim, do të punoj me interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem në mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë, të ligshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe integritetin institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjin e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohem!

Ju faleminderit!

Lus deputetët që secili personalisht të nënshkruajë deklaratën e betimit dhe në fund të seancës atë t’ia dorëzojë Sekretarisë së Kuvendit.

Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit

Në pajtim me nenin 67, paragrafi 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenin 12, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj nga grupi më i madh parlamentar, Partia Demokratike e Kosovës, që të propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

E ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike, zotin Zenun Pajaziti, që ta japë propozimin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zonja kryesuese!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, propozojmë zotin Jakup Krasniqi për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESEUSJA: Ju faleminderit!

Ju njoftoj se kryetari i Kuvendit zgjedhet me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit, më së paku 61 vota “për”. Mund ta konstatojmë se të pranishëm janë 118 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë “për”, “kundër” ose abstenim.

Kush është “për”?

I lutem Sekretarisë që t’i numërojë votat.

A ka “kundër”?

Numëroni votat, kush është “kundër”.

A ka abstenim? Dy. Ju lutem, të konstatohet numri. Edhe një herë kush është kundër, pasi që dikush ka votuar dy herë.

Kush është “kundër”?

Konstatoj se 110 deputetë kanë votuar “për”. 16 “kundër”, dy abstenime. Konstatoj se me 110 vota..., por po dalin më shumë! Po, dalin më shumë! T’ju them të drejtën, ka aq shumë gazetarë anash sa që Sekretaria nuk po mundet t’i numërojë votat.

Kush është “për”, të votojmë edhe një herë!

Numëroni, kush është “për”?

Kush është “kundër”, numëroni edhe një herë, numëroni kush është “kundër”?

Kush abstenon? Tre.

Deputeten Rada e lus të deklarojë a është “kundër” apo abstenon, sepse dy herë... “Kundër”, a po?

Mirë, atëherë 3 vota “kundër”.

Kështu është kur nuk votojmë me kartela dhe disa e ndërrojnë mendjen aty për aty, prandaj edhe shifrat po ndryshohen. Unë kërkoj falje për këtë, por konstatoj se e kemi këtë votim të fundit:

“Për” janë 90 deputetë, “kundër” 17, dhe abstenojnë 3.

Me shumicë votash zgjedhet kryetari i Parlamentit të Kosovës. Urime, zoti Krasniqi.

(Duartrokitje)

Vazhdojmë më tutje.

4. Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit

Në pajtim me nenin 67, paragrafi 3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenin 12, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, për tri grupet më të mëdha parlamentare, që janë:

Partia Demokratike, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe “Vetëvendosja”, propozohet nga një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Zenun Pajaziti, që të propozojë për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatin e tyre.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zonja kryesuese!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozon për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotin Xhavit Haliti.

KRYEUSESJA: Vazhdojmë.

Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që ta propozojë kandidatin e vet për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës.

ISMET BEQITI: Lidhja Demokratike e Kosovës, gjegjësisht Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës për nënkryetar të Parlamentit të Republikës së Kosovës propozon deputetin, akademik Sabri Hamiti.

KRYESUESJA: Ju faleminderit!

Tani e ftoj Grupin Parlamentar “Vetëvendosje” që të propozojë kandidatin e vet për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

VISAR YMERI: Lëvizja “Vetëvendosje”, e propozon Glauk Konjufcën për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESJA: Ju faleminderit!

Ju njoftoj se nënkryetarët e Kuvendit zgjedhet me shumicë votash edhe gjithashtu votohet “për”, “kundër” dhe abstenim.

Lus deputetët që me ngritje dore (minoritet i votojmë më vonë) të votohet për tre nënkryetarë të grupeve më të mëdha. Prandaj, votojmë për këta tre nënkryetarë, domethënë në grup, sipas propozimeve.

Kush është “për”? Ju faleminderit! Ju lutemi, mbani duart lart, sepse Sekretaria dihet t’i numërojë votat në mënyrë të saktë.

Kush është “kundër”? Nuk ka “kundër”.

A ka abstenime?

Konstatohet se 100 vota janë “për”, “kundër” nuk ka, 14 abstenime.

Atëherë, konstatohet se 3 (tre) nënkryetarët nga partitë më të mëdha që përfaqësohen në Parlamentin e Kosovës, u zgjedhën:

1. Xhavit Haliti,
2. Sabi Hamiti, dhe
3. Glauk Konjufca

Urime!

Shkojmë me zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e minoriteteve. Sipas nenit 67, paragrafi 4 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 4 të Rregullore së Kuvendit, deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetin Serb, propozojnë një kandidatë për nënkryetar të Kuvendit dhe deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetet tjera që nuk janë shumicë, propozojnë një kandidat për nënkryetar të Kuvendit.

Ftoj përfaqësuesit e deputetëve të komunitetit Serb të propozojnë nënkryetarin e Kuvendit.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Koristim priliku da čestitam predsedniku i potpredsednicima, u ime Srpske zajednice! Predlog za potpredsednika parlamenta je Petar Miletić.

KRYESUESJA: A e dëgjuat? Još jednom, nismo čuli.

SLOBODAN PETROVIĆ: U ime Srpske zajednice, predlog za potpredsednika je Petar Miletić.

KRYESUESJA: Ftoj përfaqësuesin e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, të propozojnë kandidatin e tyre për nënkryetar të Parlamentit.

(Deputetja Rada Trajković kërkon fjalën për debat)

KRYESUESJA: Më falni, në këtë seancë nuk ka debat. Urdhëro, zoti Mahir!

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zonja kryesuese!

Öncelikle tüm milletvekillere seçildiklerinden dolayı tebrik ediyorum, Kosova'ya hayırlı uğurlu olsun.

“6+” Grup adına, diğer topluluklar adına, ilk dönem için milletvekili Enis Kervan'ı öneriyoruz.

KRYESUESJA: Konstatoj se propozohet z. Enis Kervan.

Këto dy propozime gjithashtu dushet t'i votojmë të gjithë.

Kush është “për”?

E lus Sekretarinë që t'i numërojë votat. Ndoshta duhet të ngrehin pak më lart dorën se disa nuk po shihen.

A ka “kundër”?

A ka abstenime?

Atëherë, konstatoj se “për” janë 68, “kundër” janë 15 dhe abstenojnë 14 deputetë.

Konstatoj se deputetët Petar Miletić dhe Enis Kervan, zgjedhen nënkryetarë të Parlamentit.

Më lejoni të konstatoj se rishtas Parlamenti i Kosovës zgjodhi kryetarin dhe nënkryetarët e tij, të gjithë nga gjinia mashkullore dhe, si femër që e përfaqësoj gjininë time, nuk më erdhi mirë!

(Qeshje në sallë)

Kaq kisha fuqi, si udhëheqëse e kësaj seance, të them.

Vazhdojmë. Ftoj kryetarin e Parlamentit që të marrë postin e vet dhe ta thotë fjalën e rastit.

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Qytetarë të nderuar,

Pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe certifikimit të rezultateve të tij, sot filluam konstituimin e institucioneve të reja të Republikës së Kosovës.

Dëshiroj me këtë rast t'i uroj të gjithë deputetët përzgjedhjen e tyre anëtarë të organit më të lartë ligjvënës të Republikës së Kosovës!

Ju falënderoj, gjithashtu, në rend të parë qytetarëve për besimin që na e kanë dhënë, në rend të dytë, juve, të nderuar deputetë, për besimin që më dhatë për të kryesuar Kuvendin e Republikës së Kosovës në këtë legjislaturë.

Legjislatura e kaluar e Kuvendit ka arritur me sukses të promovojë demokracinë e kulturën parlamentare dhe të sigurojë përfaqësimin e të gjitha komuniteteve pakicë. Demokracia është realizim i lirisë për të gjithë dhe vetë institucionalizimi i lirisë. Rëndësia e Kuvendit në sistemin demokratik të Kosovës konsiston në rolin e tij legjislativ, përfaqësues dhe në atë të kontrollit mbi institucionet që zgjedh. Në këtë kuptim, Kuvendi ynë ka përpara objektiva të mëdha dhe të shumta. Kuvendit i uroj punë të mbarë në zgjedhjen e institucioneve tjera të shtetit, në përmbushjen e kornizës ligjore të vendit dhe në vështtrimin e të gjitha roleve të tij kushtetuese. Gjatë kësaj udhëheqje të këtij Kuvendi në këtë legjislaturë – në legjislaturën e katërt, ju siguroj juve dhe qytetarët e Republikës së Kosovës se gjithçka do të jetë mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Të nderuar anëtarë të ri të Kryesisë së Kuvendit, edhe juve ju uroj detyrat dhe përgjegjësitë që morët sot me votën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pas përfundimit të kësaj seance, unë ju kisha ftuar në mbledhjen e parë të Kryesisë së Kuvendit, të Kryesisë që posa doli nga vota juaj, që t'i shqyrtojmë objektivat tjera që i kemi ne si Kryesi e re e Kuvendit të legjislaturës së katërt.

Kërkoj nga deputetët, pasi Kryesia do t'i shqyrtojë kërkesat që vijnë nga koalicioni, të vendosim për seancat e ardhës. Ju faleminderit!

Kryesinë e ftoj menjëherë, në ora 15:00 po e lëmë, për t'u njoftuar me vendimin e Kryesisë së re. Kryesinë e kisha ftuar në ora 13:00, në sallën 301. Dhe, me këtë e mbylli seancën konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

* * *

Njoftim pas mbledhjes së Kryesisë(ora 15:00)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Kryesia, në mbledhjen e saj shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, por kërkesa e Grupit Parlamentar nuk ishte për seancë të re, ishte për vazhdim të seancës dhe Kryesia nuk ka pasur lëndë për të shqyrtuar dhe për ta thirrur seancën e re të rregullt për zgjedhjen e presidentit dhe të kabinetit qeveritar.

Ky është, si të them, vendimi i Kryesisë së re të Kuvendit, që doli nga zgjedhja e sotme dhe ne, si Kryesi, do të takohemi nesër, para dite, në ora 10:00. Urdhëro, Hajredin!

HAJREDIN KUQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ne pajtohemi me qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës ngase jemi ithtarë të respektimit të plotë të Kushtetutës dhe të ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores së Punës të Kuvendit. Mbi bazën e saj, ne kemi deponuar sot një kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme për nesër në orën 15:00, me këtë rend dite:

- Zgjedhja e presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
- Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Duke u nisur nga nevoja e ndërtimit të institucioneve tona në disa muaj në mungesë të tyre, kur kemi një president ushtrues detyre dhe një qeveri në dorëheqje, kemi konsideruar se ka nevojë të bëhet një mbledhje e tillë dhe nesër t'i kompletojmë që të dy institucionet, kur dihet se tanimë kemi koalicionet qeverisëse dhe jemi të gatshëm që të shkojmë në zgjedhjen e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë i njoftoj deputetët se Kryesia, në mbledhjen e nesërme që do të mbahet në ora 10:00, do të marrë vendime për përcaktimin e kohës së mbledhjes. Ne e respektojmë kërkesën e grupit prej 40 deputetëve për ta thirrur seancën e nesërme, kështu që unë po e mbyll këtë njoftim që e patëm, se kjo nuk është seancë, dhe mirë u pafshim në seancat e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve